



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

UP 1Nr.08-333

25.08.2021

Sh k u p

Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alineja 2 dhe neni 20 paragrafi 1 alineja 10 dhe 13, në lidhje me nenin 71 paragrafi 1 alineja 17 dhe 18 dhe neni 75 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), nenit 15 paragrafi 1 alineja 2, neni 39 paragrafi 1 alineja 10 dhe 13 dhe neni 51 paragrafi 1 i Rregullores për punë e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Teksti i pastruar) ark nr.01-3732/1 nga 29.07.2019, pas realizimit të Konkursit publik për dhënien e lejes për radio transmetim të servisit programor në nivel lokal, shpallur në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpalljen e konkursit publik, UP1 nr.08-233 nga 22.04.2021 („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.90/21), në pajtueshmëri me Raportin për vlerësimin e fletëparaqitjes së parashtruar Up1 nr.08-333 nga 19.08.2021 dhe konkluzionin nr.ark.02-3165/2 nga 24.08.2021, të seancës së 23-të mbajtur më 24.08.2021, miratoi si më poshtë:

VENDIM

Për dhënien e lejes për radio transmetim të shërbimeve programore muzikë-radio folëse nga formati i përgjithshëm në gjuhën maqedonase, në nivel lokal në rajonin e komunës Novo Sellës

1. DHËNIA e lejes për radio transmetim të servisit programor muzikor-radio folëse i formatit të përgjithshëm, në rajonin e komunës Novo Sellës, kandidatit, personit fizik Goranço Tasev nga Strumica, me adresë banimi në fsh. Strumicë, rr.nr.259, komuna Novo Sellës, Strumicë.

Shërbimi i radio programit nga paragrafi 1 i kësaj pike do të transmetohet nëpërmjet radio frekuencës e përcaktuar nga Agjencia për komunikim elektronik e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe atë: 107.4 MHz¹.

2. Leja për radio transmetim në nivel lokal, e përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, shpërndahet për një periudhë kohore prej 9 (nëntë) vjetësh dhe e njëjta nuk mund të transferohet te një person tjetër.

3. Me marrjen e këtij Vendimi për dhënien e lejes, kandidati në konkurs, personi fizik Goranço Tasev nga Strumica, të cilit iu dha leja nga pika 1. e këtij Vendimi, duhet të regjistrohet si një shoqëri tregtare radiodifuzive në regjistrin përkatës, në përputhje me nenin 77 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

¹ Lokacioni ku do të jetë vendosur përcjellësi duhet të sigurojë transmetim në radio në kufijt e rajonit për transmetim për të cilën lëshohet leja.

Shoqëria tregtare radiodifuzive, e cila do të krijohet nga kandidati në konkurs, personi fizik Goranço Tasev nga Strumica të cilit iu dha leja nga pika 1. i këtij Vendimi, do të paguajë një tarifë vjetore për lejen e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, për çdo vit aktual duke filluar nga data e ndarjes së lejes në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të fakturës e dhënë nga Agjencia. Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe arkëtimit, tarifa e lejes përcaktohen nga Agjencia në përputhje me nenin 80 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe Rregulloren për procedurat e operacionit financiar dhe auditues të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.185/14), Rregulloren mbi formatet e shërbimeve programore të transmetuesve („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.172/14) dhe Rregulloren për fushat e transmetimit të programeve televizive dhe radio („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.172/14).

4. Agjencia për komunikim elektronik bazuar në lejen për radio transmetim duke përdorur radio frekuenca lëshon miratim për përdorimin e radio frekuencave në përputhje me Ligjin për komunikimet elektronike.

Për përdorimin e frekuencave të radios, paguhet një tarifë vjetore në fakturë të Agjencisë për komunikim elektronik për çdo vit aktual paraprakisht nga data e vlefshmërisë së autorizimit për përdorimin e frekuencave të radios.

5. Shoqëria tregtare e radiodifuzive, e cila do të themelohet nga kandidati në konkurs, personi fizik Goranço Tasev nga Strumica, të cilit iu dha leja bazuar në pikën 1. i këtij Vendimi, është i obliguar të fillojë me veprimtari më 27.12.2021.

Në rast mosrespektimi të afatit për fillimin e veprimtarisë të përmendur në paragrafin 1 të kësaj pike nga Vendimi, Agjencia do ta revokojë vendimin për leje para skadimit të afatit për të cilën është lëshuar dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

6. Personi fizik, i referuar në pikën 1 të këtij Vendimi, të cilit i është ndarë leja për radio transmetim është i detyruar gjegjësisht ti plotësojë kushtet dhe kërkesat ndaj të cilave u obligua në Aplikim gjatë konkursit.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele do të kryejë një mbikëqyrje eksperte brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga skadimi i ditës së tridhjetë nga dita e fillimit të veprimtarisë të vërtetuar me lejen e radio transmetimit, me qëllim konstatimin e plotësimin të kushteve teknike, hapësinore dhe të personelit, në pajtueshmëri me kërkesën për marrjen e lejes për radio transmetim.

7. Për këtë Vendim njoftohet me shkrim pjesëmarrësi në konkursin publik, për ndarjen e lejes për radio transmetim të një shërbimi programor në nivel lokal, në rajonin e komunës Novo Sellës, në afat brenda 7(shtatë) ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

8. Ky vendim është përfundimtar dhe shpallet në „Gazetën zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Arsytim

Në bazë të nenit 69 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, për shërbimin e programeve tokësore të radios që transmetohet përmes një burimi të kufizuar siç janë radiofrekuencat, Agjencia jep leje për radio transmetim përmes konkursit publik.

Agjencia në përputhje me nenin 70 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, merr vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio transmetim, sipas detyrës zyrtare ose me pranimin e një kërkesë me shkrim nga pala e interesuar, në përputhje me Planin për dhënien dhe përdorimin e radio frekuencave si dhe në përputhje me mënyrën dhe procedurën e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit të lartpërmendur.

Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio transmetim të shërbimit programor në nivel lokal në rajonin e komunës së Novo Sellës, UP1 nr.08-233 nga 22.04.2021. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.90/21 nga 23.04.2021.), bazuar në Letrën për qëllim (kërkesë me shkrim) e dorëzuar më 14.12.2020 në adresën zyrtare të e-mail të Agjencisë (contact@avmu.mk), nga personi fizik Goranço Tasev nga Strumica, për marrjen e lejes për radio transmetim të shërbimit

programor në nivel lokal në rajonin e komunës Novo Sellës dhe në rajonin e komunës Bosillov, nr.ark.08-4510/1 nga 14.12.2020, Plotësimi i Letrës së qëllimeve, nr.ark.08-69/1 nga 08.01.2021 (në të cilën ishte sqaruar se kërkesa me shkrim për marrjen e lejes i referohet vetëm komunës së Novo Sellës), Njoftimi i paraqitur nga Agjencia për komunikimet elektronike të RMV në lidhje me kërkesën për informacion mbi frekuencat falas për transmetimin e radio programit në rajonin e komunës së Novo Sellës, nr.0805-3225/2 nga 30.12.2020 (nr.ark .08-45/1 nga 05.01.2021), dhe në përputhje me Studimin e përgatitur për përcaktimin e justifikimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio transmetim në nivel lokal, në rajonin e komunës Novo Sellës (nr.ark.08-1581/1 nga 07.04.2021).

Afati i fundit për paraqitjen e aplikimit për pjesëmarrjen në konkursin publik ishte deri më 22.07.2021 gjegjësisht kandidatët në konkurs duhej të aplikonin brenda 90 (nëntë dhjetë) ditëve, dhogaritur nga dita e parë pas ditës së shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përfundimisht deri më 22.07.2021 (afati i fundit për paraqitjen e aplikacioneve), deri te Agjencia ishte dorëzuar vetëm 1 (një) aplikim me dokumentet shoqëruese për dhënien e lejes për radio transmetim të shërbimit programor në nivel lokal në komunën e Novo Sellës më 22.07.2021 nga kandidati, personi fizik Goranço Tasev nga fsh.Sushicë, komuna Novo Sellës, Strumicë (Up1 nr.08-333).

Hapja publike e Aplikacionit të paraqitur për pjesëmarrje në konkursin publik nga kandidati i mësipërm u mbajt 1 (një) javë pas afatit për dorëzimin e aplikacioneve, gjegjësisht deri më 29.07.2021, ku aplikacioni i paraqitur u shqyrtua në lidhje me atë nëse është i rregullt, në kohë dhe i plotë, gjegjësisht nëse i përmban të gjitha dokumentet të parapara në nenin 73 paragrafi 3 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, të cilat i referohen kandidatit-personit fizik, për të cilin janë mbajtur procesverbale nga hapja publike (Up1 nr.08-333) nga 29.07.2021.

Në periudhën nga 30.07.2021 deri më 11.08.2021, nga ana e Sektorëve kompetent në Agjencia iu qasën vlerësimit të aplikacionit të paraqitur për lëndën e konkursit publik me Subjekt (Up1 nr.08-333 nga 22.07.2021) të paraqitur nga kandidati, personi fizik Goranço Tasev nga komuna Novo sellës, Strumicë. Aplikimi i paraqitur brenda afatit të përcaktuar ishte vlerësuar nga Sektorët kompetent në Agjenci, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuar në tabelën në pikën 5 të Vendimit Up1 nr.08-233 nga 22.04.2021 për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio transmetim dhe shërbimeve programore në nivel lokal. Sektori për çështjet programore i vlerësoi kriteret nga pika 1, pika 2, pika 3, pika 4 dhe pika 7 e tabelës; Sektori për planifikimin strategjik dhe mbrojtjen e të drejtave autoriale vlerësoi kriterin nga pika 5 e tabelës; Sektori i finansave dhe logjistikës e vlerësoi kriterin nga pika 9 e tabelës dhe Sektori për mbështetjen e informacionit dhe çështjet e përgjithshme i vlerësoi kriteret nga pika 6, 8 dhe pika 10 nga tabela.

U konstatua se Fletëparaqitja e dorëzuar Up1 nr. 08-333 më datë 22.07.2021, nga kandidati, personi fizik Goranço Tasev nga Komuna e Novo Sellës, Strumicë, është në rregull dhe pason vlerësimi dhe notimi i së njëjtës.

Kështu, Sektori për çështje programore, në kontributin e dorëzuar më 06.08.2021, konstatoi se Fletëparaqitja është në rregull nga aspekti programor dhe pason notimi i mëtejshëm i së njëjtës, dhe në: pika 1 e tabelës - Përfaqësimi i programit e prodhuar nga ana e vetë radiodifuzerit (in-house production) gjatë javës, si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se përfaqësimi i programit të paraparë prodhuar nga ana e vetë radiodifuzerit është 100% sa edhe kohëzgjatja e pjesës së folur të programit (8 orë dhe 20 minuta), pika 2 e tabelës – Kualiteti dhe llojllojshmëria e zhanrit dhe tematikës së përmbajtjeve, si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se në pjesën e folur e programit është treguar se do të jenë përfaqësuar 5 (pesë) lloje programesh të cilat plotësojnë funksionin informativë dhe argëtues, pika 3 e tabelës – Përfaqësimi i programëve me të cilët nxitet zhvillimi dhe ruajtja e kulturës nacionale, si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se përfaqësimi i planifikuar i muzikës vokale dhe/ose vokale instrumentale në gjuhën maqedonase dhe muzikës instrumentale nga autorë maqedonas gjatë ditës është 40%, ndërsa aspak nuk do të transmetojë programe për ruajtjen e kulturës nacionale, pika 4 e tabelës – Përfaqësimi i informacioneve dhe përmbajtjeve ne pjesën e folur të programit, të rëndësishme për zonën në të cilën do të transmetohet servisi programor (informacione me karakter lokal), gjatë javës, si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se përfaqësimi i treguar i informacioneve dhe përmbajtjeve të rëndësishme për zonën në të cilën do të transmetohet servisi programor (informacione me karakter lokal), gjatë javës, në pjesën e folur të programit është 5 orë dhe pika 7 e tabelës – Koha e ofruar të programit

trasmëtues ditor, si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se kandidati planifikon të transmetojë nga 24 orë programë në ditë. Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, Hë kontributin e dorëzuar në 03.08.2021 konstatoi se Fletëparaqitja e dorëzuar është e plotësuar në rregull, se është e kompletuar (është dorëzuar deklaratë e notuar se kandidati nuk i shkel dispozitat e Kapitullit IV të LSHMAAV), se i plotëson kushtet minimale të stafit të përcaktuara në nenin 9 paragrafi 4 nga Rregullorja për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të stafit për marrjen e lejes për transmetim të radios dhe televizionit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 172/14 dhe 76/15) dhe si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se në përputhje me Fletëparaqitjen, tek radiodifuzeri do të angazhohen gjithësej 5 persona, nga të cilët 2 si gazetarë me shkollë të lartë, dhe e ka bërë notimin e mëtejshëm i së njëjtës në pikën 5 të tabelës – Numri dhe struktura e të punësuarve të nevojshëm për realizimin e veprimtarisë (së paku 3 të punësuar, nga të cilët 2 gazetarë me shkollë të lartë). Sektori për financa dhe logjistikë, në kontributin e dorëzuar në 10.08.2021 konstatoi se dokumentet e dorëzuar me Fletëparaqitjen e dorëzuar, nga aspekti financiar, janë të kompletuara dhe si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se kandidati ka dorëzuar Biznis plan në të cilin është përmbajtur dhe plani financiar i paraparë të radios për 5 (pesë) vitet e ardhshme, si dhe garancione të ofruara për aftësi financiare për realizimin e veprimtarisë, kandidati ka dorëzuar pronësi në depozita bankare dhe pasuri të patundshme në pronësi të aplikantit, me vlerësim të realizuar nga vlerësues zyrtar, dhe e ka bërë notimin e mëtejshëm të së njëjtës në pikën 9 të tabelës – Garancione të ofruara për aftësi financiare për realizimin e veprimtarisë. Sektori për mbështetje informatike dhe çështje të përgjithshme, në kontributin e dorëzuar në 11.08.2021 konstatoi se Fletëparaqitja e dorëzuar e kandidatit-personi fizik Goranço Tasev nga fsh. Sushicë, komuna e Novo Sellës, Strumicë, dhe ka bërë notimin e mëtejshëm të së njëjtës, dhe në: pika 6 e tabelës – Kushtet teknike për prodhimin e programeve, si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se në formularin nr.2 ku plotësohen kushtet teknike për prodhimin e programeve kandidati i ka plotësuar kushtet e kërkuara nga Rregullorja për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të stafit për marrjen e lejes për transmetim të radios dhe televizionit, pika 8 e tabelës – Kushtet hapësinore për realizimin e veprimtarisë, si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se në të njëjtin formular nr.2, ku janë paraqitur edhe kushtet hapësinore për realizim e veprimtarisë, kandidati i ka plotësuar kushtet e kërkuara në përputhje me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të stafit për marrjen e lejes për transmetim të radios dhe televizionit dhe pika 10 e tabelës – Afat i ofruar për fillimin e realizimit të veprimtarisë, si shpjegim për plotësimin e kriteriumit deklaroi se kandidati në fletëparaqitjen, si afat për fillimin e realizimit të veprimtarisë e ka deklaruar 27.12.2021 që do të thotë mbi 3 (tre), muaj nga dita e dhënies së lejes.

Në bazë të vlerësimit dhe notimit të realizuar të fletëparaqitjes për pjesëmarrje në konkursin publik të kandidatit personi fizik Goranço Tasev nga fsh. Sushicë, komuna e Novo Sellës, Strumicë, numri total i pikëve të shpërndara është 87 pikë, siç është e përcaktuar në raportin për vlerësimin e fletëparaqitjes përpunuar nga ana e Agjencionit Up 1nr.08-333 nga 19.08.2021 dhe ishte konstatuar se fletëparaqitja Up 1nr.08-333 nga 19.08.2021, e dorëzuar nga ana e kandidatit të vetëm, personi fizik Goranço Tasev nga fsh. Sushicë, komuna e Novo Sellës, Strumicë, i plotëson kushtet e përcaktuara në konkursin publik në përputhje me vendimin e Agjencionit për shpalljen e konkursit publik Up108-233 nga 22.04.2021 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.90/21).

Për përcaktimin e saktë të fakteve gjatë marrjes së vendimit për lëshimin e lejs për transmetim të radios, domethënë që të përcaktohet në cilët shoqëri tregëtare paraqitet si themelues/pronar ose si udhëheqës personi fizik Goranço Tasev, më datën 16.08.2021, përmes internet sistemit distributiv të Regjistrimit qendror të RMV, Agjencioni siguroi “informacion për subjektet e lidhura” (persona udhëheqës, organtën e menaxhimit, pronarë në subjekte të tjera-dokument për statusin aktual), nr. ynë. nr .03-3131/1 nga 17.08.2021), dhe ishte konstatuar se nuk shkelen dispozitat nga Kapitulli IV nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Në lidhje me raportin e vlerësimit të fletëparaqitjes së dorëzuar për pjesëmarrje në konkursin publik për lëshimin e lejes për radio në nivel lokal Up108-333 nga 19.08.2021 Mr. Dagicja Ljubevska, personi i autorizuar nga ana e drejtorit të Agjencisë, në përputhje me Autorizimin, nr.ark 032951/1 nga 06.08.2021 deri te Këshilli i Agjencisë dorëzoi Propozim Up

1 nr.08-333 nga 19.08.2021, për marrjen e vendimit për lëshimin e lejes për servis programor të radios, në nivel lokal, kandidatit, personi fizik Goranço Tasev me banim në fsh. Sushicë, rr.nr.259, Komuna e Novo Sellës, Strumicë.

Në bazë të tekstit të përmendur më lartë, Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 2 dhe nenit 20 paragrafi 1 alineja 10 dhe në lidhje me nenin 71 paragrafi 1 alinejat 17 dhe 18 dhe nenin 75 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, neni 15 paragrafi 1alineja 2, neni 39 paragrafi 1 alineja 10 dhe neni 51 paragrafi 1 të rregullores për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (tekst i pastruar) nr.ark.01-3732/1 nga 29.07.2019, pas realizimit të konkursit publik për lëshimin e lejes për transmetim të servisit programor të radios në nivel lokal, i shpallur në bazë të vendimit të Agjencisë për shpalljen e konkursit publik, Up1 nr.08-233 nga 22.04.2021 („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.90/21), në përputhje me raportin nga vlerësimi i fletëparaqitjes së dorëzuar (UP1 nr.08-333 nga 19.08.2021) dhe Konkluzioni nr.ark 02- 3165/2 nga 24.08.2021 , mori vendimin si në dispozitivin, i cili është final dhe pas marrjes së tijë do të publikohet në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në veb faqen e Agjencisë.

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuale,
Kryetar i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI d.v**

Kishillë juridike: Pjesëmarësi i konkursit për dhënien e lejes për transmetim të servisit programor të radios në nivel lokal, i shpallur në bazë të vendimit Up1 nr.08-233 nga 22.04.2021 për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim të servisit programor të radios në nivel lokal („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.90/21), nëse është i pakënaqur nga vendimi, ka të drejtë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë nga dita e marrjes së Vendimit të ngrejë akt padi deri tek Gjykata administrative e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Egzemplarë nga Vendimi të dorëzohet deri:

- pjesmarësi i konkursit, Goranço Tasev nga fsh. Sushicë, Komuna e Novo Sellës, Strumicë;
- Agjencioni për komunikime elektronike;
- Drejtori i Agjencisë/personi i autorizuar i cili e zëvendëson;
- të gjithë sektorët në Agjenci dhe
- personat e caktuar për mbajtjen e Regjistrit të rasteve për procedurën e shkallës së parë në Agjenci (Up1).